REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA IUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/7878
Nr. i faq. 3
Data 02/10/2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Junikut
Opština Junik- Municipality of Junik

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12.2 (c), dhe nenit 17 (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15.7, nenit 34 (paragrafi 2 dhe paragrafi 7) dhe nenit 80 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022), si dhe nenit 22.1 të Statutit të Komunës, të datës 29.09.2010, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur më 28.09.2026, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR

NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E JUNIKUT NR. 2-180/5698 E DATËS 03.07.2023

Neni 1

TARIFA PËR GRUMBULLIM, TRANSPORTIM DHE DEPONIM TË MBETURINAVE

1- Kategoritë e konsumatorëve do të paguajnë faturë mujore për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave si në vijim:

a. **Kategoria e konsumatorëve shtëpiak – amvisëritë:** Nënkategoria e pare dhe Nënkategoria e dyte konsumatoret (banoret resident) do të paguajnë tarifë fikse 7.00 € (me TVSH) ne muaj.

Nënkategoria e tretë, konsumatoret (banoret jo resident) do të paguajnë tarifën fikse në vlerë prej 2.50 Euro (me TVSH) në muaj.

b. **Kategoria e konsumatorëve Komercial / Industrial.**

1. **Nënkategoria e pare:** veprimtarit e vogla zejtare dhe shërbyese do të paguajnë tarifë fikse prej 7.00 Euro (me TVSH) në muaj.

2. **Nënkategoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industrial me kosto të ulët të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 12.50 Euro (me TVSH) në muaj.

3. **Nënkategoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industrial me kosto të moderuar të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 19.50 Euro (me TVSH) në muaj.

4. **Nënkategoria e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 29.00 Euro (me TVSH) në muaj. Në këtë kategori kemi edhe biznese ë mëdha me kontrata te veqanta fikse.

5. **Nënkategoria e pestë:** subjektet komerciale / industriale të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë 1.1 m^3 dhe 7m^3 do të paguajnë tarifë prej 16.00 Euro (me TVSH), për një zbrazje për kontejnerë 1.1m^3 dhe 50.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje për kontejnerë 7m^3

6. **Kategoria e konsumatorëve institucional:** Të sherbyer me kontrata të vecanta, konkretisht me kontinjerë 1.1 m^3 do të paguajnë tarifë prej 16.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje dhe 50.00 Euro (meTVSH) për një zbrazje për kontejnerë 7m^3.

Neni 2

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullorës per Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut do të jetë pjesë e tekstit bazë të rregullores në fuqi.

Neni 3

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut, ky ndryshim dhe plotësim i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8. lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

KUVENDI I KOMUNËS SË JUNIKUT

Leonard Llolluni

Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut

Datë: 28.09.2026